

STATUTI
I
SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR

“AZG STANDARD” Sh.p.k.

Mbi bazën e kërkesave të ligjit Nr. 9901 të datës 14.04.2008 “Përshoqëritë tregtare” dhe të ligjit Nr. 9723 të datës 03.05.2007 “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit” krijohet shoqëria tregtare “AZG STANDARD” sh.p.k., e cila do të veprojë në përputhje me legjislacionin shqiptar në fuqi.

KAPITULLI I
EMERTIMI, OBJEKTI I VEPRITARISE, SELIA , KOHEZGJATJA

NENI 1

EMERTIMI I SHOQERISE DHE THEMELUESIT

Krijohet shoqëria tregtare e emërtuar “AZG STANDARD” sh.p.k., me ortake:

1. Ortaku Znj.**Tefta Bashllari**, lindur në Hociisht , Shqiperi, me 24.03.1956, e identifikuar me Kartë Identiteti me Nr Personal : F65324104E ;

NENI 2

SELIA

Shoqëria e ka selinë e saj në adresën:Rruga “Pjetër Arbenori” Pallati RNK ,Nr.21 , Astir, Tiranë Shqiperi .

Shoqëria mund të çele, seli të tjera të dyta, dege, përfaqësimi apo agjenci operative në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë dhe jashtë saj, në përputhje me ligjin në fuqi.

NENI 3
KOHEZGJATJA

Shoqëria do të ketë kohëzgjatjen e veprimtarisë së saj me një afat kohor të pacaktuar.

NENI 4
VULA

Shoqëria do të ketë vulën e saj.

NENI 5
OBJEKTI

Shoqëria do të ketë Statutin e njëshoqërie me përgjegjësi të kufizuar dhe do të përballojë humbje deri në kufirin e kontributit të themeluesve të saj në kapitalin fillestar.

Objekti i veprimtarisë së shoqërisë do të jetë:Aktivitetet e tjera shërbimi mbështetëse për bizneset.

KAPITULLI II
KAPITALI



NENI 6 KAPITALI THEMELTAR

Kapitali fillestarë i shoqërisë është i barabartë me 10000 (dhjetemije) leke , i cili miratohet nga ortaket, dhe nuk eshte i derdhur nga ortaket themelues dhe ndahet ne 1 (nje) kuote me vlere te barabartë me 10000 (dhjetemije) leke, qe përben 100 % (nje qind per qind) te kapitalit te shoqërisë;

Kapitali është i ndare mes ortakeve themelues si me poshtë:

- 1) Ortaku Znj. **Tefsa Bashllari** ,mbajtës i 1 (një) kuote me vlere nominale te barabartë me 10000 (dhjetemije) leke qe përben 100% (njeqind per qind) te kapitalit te shoqërisë;

NENI 7 PJESEMARRJET NE KAPITALIN THEMELTAR

Pjesëmarrjet e ortakeve ne kapitalin themeltar përcaktohet ne raport te drejte me kontributet e tyre ne kapitalin themeltar.

Te drejtat, përfshirë edhe te drejtat e votës, u takojnë ortakeve ne mënyrë përpjesëtimore me pjesëmarrjen qe zotëron secili ne kapitalin themeltar.

Ne rast tjetërsimi te pjesëmarrjes ne kapitalin themeltar, ortaket e tjerë gëzojnë te drejtën e parablerjes. Me “tjetërsim” nënkuptojmë çdo akt tjetërsimi i kuotave, ne kuptimin me te gjere te fjalës, si ne pronësi te plote ashtu dhe te pjesshme, qe, ne mënyre direkte apo indirekte, sjell ndryshimin e titullit te pronësisë mbi kuotat ose te drejtat mbi to.

Ortaku qe synon te tjetërsojë, tërësisht ose pjesërisht, kuotat e tij ne kapitalin themeltar duhet t'i komunikojë ortakeve te tjerë ne asamble ose nëpërmjet letre rekomande, ofertën e marre, duke treguar emrin e blerësit te mundshëm dhe kushtet e tjetërsimit, ne mënyrë te veçante çmimin e përcaktuar dhe mënyrat e pagesës (këtu e me poshtë oferta).

Brenda njëzet ditëve nga marrja e komunikimit te Ofertës, ortaket e interesuar ne ushtrimin e se drejtës se parablerjes duhet t'i komunikojnë ortakut qe kalon te drejtat mbi kuotat, dëshirën për te ushtruar te drejtën e parablerjes, përpjesëtimisht me pjesëmarrjen e secilit ne kapitalin themeltar dhe sipas kushteve te Ofertës, duke shprehur edhe interesin e mundshëm për blerjen e pjesës se kuotave për te cilën nuk është ushtruar e drejta e parablerjes nga ana e ortakeve te tjerë. Është i pavlefshëm çdo komunikim qe nuk përmban te gjithë te dhënat e mësipërme.

Ne rast se ndonjë nga personat qe gëzon te drejtën e parablerjes se kuotave, nuk mund ose nuk dëshiron ta ushtroje atë, e drejta e parablerjes qe i takon zmadhohet automatikisht dhe përpjesëtimisht ne favor te ortakëve qe kane shprehur interesin për ta ushtruar këtë te drejte.

Ne rast se janë disa ortake qe ushtrojnë te drejtën e parablerjes, kuotat do te shpërndahen ndërmjet tyre ne përpjesëtim me pjesëmarrjen e secilit ne kapitalin themeltar te shoqërisë. Ne rast se ne letrën e komunikimit te Ofertës tregohet si blerës i mundeshme një person qe është ortak, edhe atij i njihet e drejta e parablerjes, krahas ortakeve te tjerë.

E drejta e parablerjes duhet te ushtrohet për te gjithë pjesëmarrjen e ofruar dhe për çmimin e përcaktuar, duke qene se i tille është objekti i propozimit te paraqitur nga ortaku ofrues.

Ne rastin e ushtrimit te se drejtës se parablerjes, nënshkrimi i kontratës se shitjes se kuotave dhe pagesa përkatëse duhet te kryhen brenda afateve te përcaktuara ne propozimin e shitjes se formuluar nga ortaku ofrues.

Nëse e drejta e parablerjes nuk ushtrohet brenda afateve te mësipërme dhe për tërësinë e pjesëmarrjes se ofruar, ortaku ofrues mund t'i transferojë kuotat e veta ne favor te blerësit te treguar ne komunikimin e Ofertës dhe ne kushtet e parashikuara ne te, brenda gjashtëdhjetë ditëve te ardhshme. Ne te kundërt procedura e parablerjes duhet te përsëritet.



Ne rast tjetërsimi të kuotave në favor të të tretëve, pa zbatuar dispozitat e parashikuara me sipër, blerësi nuk do të legjitimohet në ushtrimin e të drejtave administrative dhe pasurore dhe tjetërsimi i kuotave nga ana e tij nuk do të prodhojë efekte ndaj shoqërisë.

Nëse asnjëri prej ortakëve nuk e ushtron të drejtën e parablerjes në mënyrat e përcaktuara, ortaku ofruar mund të nënshkruajë aktin e shitjes së pjesës së tij në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi. E drejta e parablerjes nuk është domosdoshmërisht e nevojshme të ushtrohet prej ortakëve, në rast transferimi tek familjarët, të kuotave ose të pjesëve të kuotave të zotëruara prej tyre.

NENI 8 ZMADHIMI DHE ZVOGELIMI I KAPITALIT

Kapitali i shoqërisë mund të shtohet ose të pakësohet me vendim të Asamblesë së Ortakëve, por asnjëherë nuk mund të zvogëlohet në nivelin e kapitalit fillestar të derdhur.

NENI 9 TRANSFERIMI I KAPITALIT

Kuotat e kapitalit të njëshoqërie me përgjegjësi të kufizuar e të drejtat që rrjedhin prej tyre mund të fitohen apo kalohen nëpërmjet:

- a. Kontributit fillestar;
- b. Shitblerjes;
- c. Trashëgimisë;
- d. Dhurimit;
- e. Çdo mënyretjetër të parashikuar në ligj.

Ortakët mund të shesin pjesërisht apo tërësisht kuotat e tyre të kapitalit. Shitja e kuotave tek të tretet behet vetëm pasi të ketë marrë vendim Asambleja e Ortakëve dhe nëpërmjetkontratës së shitjes së kuotave të kapitalit.

KAPITULLI II ORGANET DREJTUESE

NENI 10 ORGANET DREJTUESE

Organet drejtuese të shoqërisë janë:

- Asambleja e Ortakëve;
- Administratori.

NENI 11 ORGANI VENDIMARRËS

Asambleja e Ortakëve është organi i vetëvendimmarrës i shoqërisë, ortakët vendosin mbi çështjet që i rezervohen nga ligji ose nga ky Statut, si dhe mbi çështjet që njëri ose disa prej administratorëve i paraqesin për miratim.

Ortakët gëzojnë të drejtën të thërrasin asamblenë e ortakëve në rastet dhe me shumicat e përcaktuara në ligj.

Janë në çdo rast në kompetencë të Asamblesë që vendos me mazhorancë të thjeshtë të votave të ortakëve pjesëmarrës kur janë prezent më shumë se 30 % e kuotave të kapitalit themeltar, për vendimet që kërkojnë shumicë të zakonshme, si më poshtë:

1. Emërtimin e shkarkimin e administratorit;



2. Emërtimin dhe shkarkimin e likuiduesve dhe të eksperteve kontabël të autorizuar, duke përcaktuar në këtë rast kriteret e likuidimit;
3. Përcaktimin e shpërblimeve për personat e përmendur në pikën 1 dhe 2;
4. Çështje të tjera të parashikuara nga ligji apo Statuti.

Janë në kompetencën e Asamblesë së Ortakeve e cila vendos me votën në favor të $\frac{3}{4}$ të ortakeve prezent që përfaqësojnë me shume se gjysmën e kapitalit të shoqërisë, vendimet që kanë lidhje me :

1. Miratimin e bilancit dhe shpërndarjen e fitimeve;
2. Ndryshimet e këtij statuti;
3. Zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit themeltar;
4. Ndryshimin e formës së shoqërisë apo riorganizimin e saj;
5. Shpërndarjen e shoqërisë.

Asambleja mund të mblidhet në mënyrën të jashtëzakonshëm kur e kërkojnë administratori apo me shume se një e treta e ortakeve të shoqërisë. Në mbështetje të nenit 88 të ligjit "Per Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", ortaket kanë të drejten për të marrë unanimisht çdo vendim, me kusht që kjo marrëveshje të bëhet me shkrim.

NENI 12 MBLEDHJA E ASAMBLESE

Asambleja e Përgjithshme mblidhet në rastet e parashikuara nga ky Statut dhe në rastet e përcaktuara nga ligji nr. 9901, i 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", ligje të tjera, dhe çdo herë është e nevojshme për të mbrojtur interesat e shoqërisë. Takimi i rregullt i Asamblesë së Përgjithshme është bërë të paktën një herë në vit.

Asambleja e Përgjithshme thirret nga administratori ose nga ortaket në përputhje me nenin 12 të këtij statuti.

Asambleja e Përgjithshme mblidhet në qoftë se, nga pasqyrat financiare vjetore apo prospektet e rezultateve të ndërmjetme, ekziston rreziku që fitimet e kompanive nuk i mbulojnë detyrimet e duhura për 3 muajt e ardhshëm.

Asambleja e Përgjithshme mblidhet kur shoqëria, brenda dy viteve të para të krijimit të saj, propozon të blejë nga një ortak, asetet me një vlerë mbi 5% të asetëve të shoqërisë që rezultojnë nga deklaratat e fundit financiare e certifikuar.

Në rastet e parashikuara në pikat 3 dhe 4 të këtij neni, duhet t'i paraqitet Asamblesë së Përgjithshme një raport i detajuar nga një kontabilist i autorizuar me licencë i pavarur.

Nëse asambleja nuk mund të mblidhet për shkak të mungesës së kuorumit, mbledhja thirret përsëri brenda 30 ditëve me të njëjtin rend dite.

NENI 13 THIRRJA E ASAMBLESE

Asambleja e ortakeve e thirrur rregullisht përfaqëson bashkësinë e ortakeve dhe vendimet e saj të marra në përputhje me ligjin dhe këtë statut janë të detyrueshme për të gjithë ortaket edhe nëse këta mungojnë ose nuk janë të menjëhershëm të pranishëm.

Asambleja e Ortakeve thirret me një njoftim me shkrim të dërguar ortakeve në vendbanimin e tyre ose në adresën e postës së tyre elektronike.

Njoftimi me shkrim ose me e-mail, duhet të tregojë vendin, datën dhe orën e mbledhjes dhe rendin e ditës dhe duhet t'i komunikohet të gjithë ortakeve, jo më vonë se 7 ditë para datës së caktuar për mbledhjen e asamblesë.



Njoftimi për thirrjen e asamblesë është bërë me shkrim dhe do të dorëzohet për secilin ortak në adresën e regjistruar në regjistrin e ortakeve të paktën 7 (shtatë) ditë para mbledhjes.

Përveç sa me sipër, njoftimi për thirrjen e asamblesë mund të bëhet nëpërmjet dorëzimit të tij administratorit, ky i fundit ka përgjegjësinë e dorëzimit të këtij njoftimi, ortakeve .

Në numërimin e shtatë ditësh nuk merret parasysh, dita e dorëzimit të njoftimit dhe dita e mbajtjes së mbledhjes.

Kur asambleja nuk është mbledhur në mënyrën e përshkruar më lart, ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm në qoftë se është përfaqësuar tërësia e kapitalit themeltar dhe asnjë nga anëtarët nuk kundërshtojnë diskutimin e çështjeve në rend të ditës.

Asambleja drejtohet nga administratori. Drejtuesi i Asamblesë konstaton mbledhjen e rregullt të saj, verifikon identitetin dhe legjitimitetin e të pranishmeve, drejton dhe garanton zhvillimin e rregullt të saj të asamblesë si dhe verifikon dhe shpall rezultatet e votimeve.

Mbledhja e Asamblesë së ortakeve mund të mbahet edhe nëpërmjet video- konferencës ose telekonferencës, me kusht që të gjithë pjesëmarrësit të mund të identifikohen dhe të dallohen në çdo moment të lidhjes dhe t'u lejohet të ndjekin diskutimin, të marrin , të dërgojnë dhe të vëzhgojnë dokumentet, të ndërhyjnë gojarisht dhe në kohe reale mbi të gjitha çështjet, si dhe të marrin pjesë në votim dhe të vendosin, në mënyrë të tillë që të mund të garantohet metoda kolegjiale dhe zbatimi i parimeve të mirëbesimit dhe barazisë së trajtimit të ortakeve. Në prani të kushteve të mësipërme, asambleja e ortakeve konsiderohet e mbajtur në vendin në të cilin gjendet drejtuesi i saj ose në vendin që tregohet në njoftimin e mbledhjes së saj. Çdo ortak ka të drejtën e pjesëmarrjes dhe të votës në asamble në përfaqësim me pjesëmarrjen që zotëron në kapitalin themeltar.

Ortakët mund të përfaqësohen në asamble nga persona të tjerë nëpërmjet një autorizimi apo prokure të posaçme. Autorizimi apo Prokura është e vlefshme vetëm për asamblesën për të cilën kërkohet, të identifikuar sipas rendit të ditës gjithashtu përfshin takime pasuese me të njëjtin rend dite. Ortaket nuk mund të përfaqësohen nga administratori i shoqërisë.

Vota duhet të jete e hapur ose gjithsesi të shprehet me modalitete të tilla që të bëjnë të mundur identifikimin e ortakeve që nuk janë në të njëjtin mendim. Modalitetet e votimit miratohen nga Asambleja e ortakeve me shumicën e të pranishmeve, mbi propozimin të administratorit.

NENI 14

AKTET DHE VERBALET E MBLEDHJES SE ASAMBLESE

Vendimet e Asamblesë së Ortakeve duhet të pasqyrohen në procesverbalin e mbledhjes. Administratorët janë përgjegjës për ruajtjen e procesverbalit të mbledhjes së asamblesë.

Procesverbali duhet të ketë datën dhe vendin e mbledhjes, rendin e ditës, emrin e Presidentit dhe i cili e mban procesverbalin, rezultatet e votimit.

Procesverbalit të Asamblesë i bashkëngjitet lista e pjesëmarrësve dhe njoftimi për mbajtjen e takimit.

Procesverbali i mbledhjes do të nënshkruhet nga të gjithë ortaket e pranishëm dhe nga ai që e përpilonatë.

NENI 15

KUNDERSHTIMI I VENDIMEVE TE ASAMBLESE

Administratorët dhe secilido ortak ka të drejtë të ankohet për vendimet e asamblesë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë, ku është selia e kompanisë, nëse vendimet janë në kundërshtim me ligjin ose me statutin.

Citati, i përshkruar në paragrafin e mëparshëm, është drejtuar kundër shoqërisë dhe duhet të dorëzohet brenda 3 (tre) muaj nga vendimi.

Nëse vendimi është kundërshtuar nga ana e administratorit të shoqërisë, Gjykata e Shkallës së Parë, ku Selia shoqëria, emëron një përfaqësues të shoqërisë në gjykatë.

Gjykimi i pavlefshmërisë ka efekt në lidhje me të gjithë ortaket dhe administratoret.
Për raste që nuk rregullohen në këtë statut do aplikohet ligji.

NENI 16 ADMINISTRIMI

Asambleja e Ortakeve ka të drejte të vendose nëse administrimi i shoqërisë do të behet nga një administrator i vetëm apo nga Këshilli Administrativ i përberë nga minimumi 3(tre) dhe maksimumi 5 (pese) administratorë.

Administrimi i shoqërisë i cili konsiston në kryerjen e të gjithë veprimeve të administrimit për realizimin e objektit të veprimtarisë së shoqërisë, i besohet administratorit të vetëm ose Këshillit Administrativ. Në rastin e Këshillit Administrativ secili nga administratoret është i detyruar të informojë Këshillin për çdo veprim të kryer dhe në rast kundërshtish vendos Asambleja e Ortakeve. Administratori i vetëm ose Administratoret (nëse janë emëruar qëndrojnë në detyrë 5(pese) vjet, me të drejte riemërimi, përveç nëse shkarkohen nga Asambleja e Ortakeve apo rastet e dorëheqjes. Kushdo që administron shoqërinë përgjigjet personalisht përballë saj dhe të trentëve për shkelje të mundshme të ligjit dhe ose statutit dhe ose gabimet e kryera gjate administrimit të shoqërisë.

Në rast të administrimit me Këshill Administrimi, ky zgjedh brenda tij President dhe një Administrator të Deleguar. Presidenti i Këshillit të Administrimit duhet të thërrasë Këshillin të paktën një here në dy muaj dhe të njoftojë Këshillin e Administrimit për mbarëvajtjen e shoqërisë. Nëse ekzistojnë mosmarrëveshje ndërmjet administratoreve, Presidenti duhet të thërrasë Asamblenë e Ortakeve, e cila mund të vendose në lidhje me kundërshtitë.

Në rastin e Këshillit Administrativ, administratoret mund të veprojnë bashke ase veç e veç. Në çdo rast, nëse ekzistojnë kundërshtime ndërmjet administratoreve këta i drejtohen Asamblesë së ortakeve, e cila dhe mund të zëvendësojë Këshillin e Administrimit e të emërojë administratore të tjerë. Administratori ose Këshilli Administrativ mund të shkarkohen në çdo moment me vendim të Asamblesë së Ortakeve me votën pro të ortakeve që përfaqësojnë shumicën e kapitalit të shoqërisë, pa detyrim motivimi. Megjithatë nëse shkarkimi është bere pa arsye të drejte, administratori mund të kërkojë dëmshpërblim financiar.

Në rastin e dorëheqjes së një administratori, brenda 30 (tridhjetë) ditëve duhet të thirret Asambleja e Ortakëve për emërimin e administratorit të ri, në rast se ky vendim nuk merret në të njëjtën mbledhje Asambleje kur është vendosur largimi i administratorit.

Shoqëria e themeluar do të administrohet nga një administrator i vetëm i cili do të qëndrojë në detyrë për një periudhë 5 vjeçare, me të drejte rizgjidhje.

Me themelimin e shoqërisë, emërohet Administrator Ortaku Znj. **Tefta Bashllari**, lindur në Hociisht , Shqipëri, më 24.03.1956, e identifikuar me Kartë Identiteti me Nr Personal : F65324104E , për 5 vjet.

Emërimi i administratoreve prodhon efekte pas regjistrimit në QKB.

NENI 17 KOMPETENCAT E ADMINISTRATORIT

Administratori ka të gjitha kompetencat për administrimin e zakonshëm dhe të jashtëzakonshëm të shoqërisë, me përjashtim të vendimeve që ligji, statuti, akti i themelimit i rezervojnë Asamblesë së Ortakeve.

Administratori gëzon të drejta të pakufizuara në lidhje me administrimin e llogariserrjedhese të shoqërisëprane cdo banke , hapjen dhe mbylljen e llogariverrjedhese në cdo moment prane cdo banke, administratori ka të drejtë për kryerjen e çdo veprimi dhe /ose operacioni që evlerësojnë të dobishëm për realizimin e objektit të shoqërisë.



Administratori drejton veprimtarinë e shoqërisë dhe ka te drejte qe ta përfaqësoje atë ne marrëdhëniet me te tretet.

Përveç asaj çka parashikohet nga ligji, Administratori ka detyrën e kryerjes se veprimeve te mëposhtme:

1. përgatit dhe harton inventarin, te llogarive vjetore dhe raportit me shkrim mbi administrimin, raportin e ecurisë se veprimtarisë se shoqërisë, ne mbyllje te çdo viti financiar dhe se bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve, ja dërgon Asamblesë se Ortakeve për miratim;
2. hartimin e projekteve te bashkimit ose te ndarjes se shoqërisë;
3. te informoje asamblenë mbi zbatimin e politikave tregtare dhe realizimin e operacioneve tregtare me rendësi për shoqërinë;
4. te raportojë përpara Asamblesë se Ortakeve mbi faktet qe mund te kenë pasoja negative mbi ecurinë apo ekzistencën e shoqërisë;
5. Administratoret mund te delegojnë përfaqësues te posaçëm për kryerjen e akteve te veçanta ose te një kategori aktesh, duke përcaktuar kompetencat përkatëse;
6. Te thërrasë Asamblenë e Ortakeve ne rastet e parashikuara me ligj;
7. Si dhe çdo te drejte tjetër e cila është përcaktuar me ligj për arritjen e qëllimit te shoqërisë

NENI 18 **PERFAQESIMI I ADMINISTRATORIT**

Administratori ka te drejtën e përfaqësimit te shoqërisë kundrejt te trentëve dhe ne gjykim. Ai mund te caktojë avokate dhe përfaqësues te shoqërisë përpara organeve gjyqësore, organeve te administratës shtetërore dhe te trentëve, si dhe përfaqësues te posaçëm për akte te veçanta apo kategori aktesh.

E drejta e firmës se shoqërisë mund te ushtrohet edhe nga personat te cilëve u është deleguar kjo e drejte brenda kufijve te kompetencave te dhëna.

Administratori ka te drejtën e rimbursimit te shpenzimeve te bëra gjate ushtrimit te funksioneve si dhe një shpërblim vjetor te përcaktuar nga asambleja e ortakeve ne momentin e emërimit ose me vendim te posaçëm.

KAPITULLI IV **VITI FINANCIAR**

NENI 19 **VITI FINANCIAR**

Veprimtaria ekonomiko-financiare e shoqërisë nis me regjistrimin e saj ne organet tatimore, ndërsa për vitet ne vijim nga data 1 janar deri me 31 dhjetor te çdo viti.

Ne fund te çdo periudhe te ushtrimit te aktivitetit hartohet bilanci kontabël, brenda afateve dhe konform ligjeve ne fuqi.

Dokumentet e kontabilitetit, te shoqëruar nëse e nevojshme nga relacioni i ekspertit kontabël te autorizuar, duhet t'u komunikohen ortakeve dhe te vihen ne dispozicionin e tyre pranë selisë se shoqërisë, te paktën 15 dite përpara datës se mbledhjes se asamblesë.

Shoqëria ka llogarinë rrjedhëse te saj si dhe librat kontabël ne përputhje me kërkesat e ligjit për kontabilitetin dhe dispozitave te tjera fiskale ne Republikën e Shqipërisë

Transferimi i vlerave monetare dhe transaksionet financiare do te kryhen ne baze te kritereve te përcaktuara nga Banka e Shqipërisë.

NENI 20 **MARRREDHENIET E PUNES**



Marrëdhëniet e punës rregullohen nëpërmjet kontratave të punës dhe konform Kodit të Punës së Republikës së Shqipërisë.

NENI 21 FITIMET

Fitimet që rezultojnë nga bilanci ushtrimor do të shpërndahen ndërmjet ortakëve pasi të jenë zbritur nga kjo shumë vlera e humbjeve të pësuar gjatë vitit ushtrimor paraardhës si dhe 5% (pese për qind) që destinohet për fondet e rezervës së domosdoshme, derisa kjo të ketë arritur kufirin e parashikuar me ligj.

Pjesa që mbetet pas zbritjes së zërave të mësipërm, do të shpërndahet pronarëve të kuotave të kapitalit themeltar përpjesëtimisht me pjesëmarrjen e tyre, në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi, me përjashtim të destinimit të ndryshëm të vendosur nga vetë ortakët.

NENI 22 FINANCIMI I ORTAKEVE

Shoqëria mund të marrë nga ortakët financime me ose pa shpërblim, në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi. Dhënia e këtyre financimeve nga ana e ortakëve është e lire.

NENI 23 MBYLLJA E AKTIVITETIT

Veprimtaria e shoqërisë pushon me vendim të Asamblesë së Ortakëve të shoqërisë kur:

1. Veprimtaria e shoqërisë është negative;
2. Veprimtaria e shoqërisë është e pamundur;
3. Shpërndahet me vullnet të ortakëve;
4. Riorganizohet në një formë tjetër;
5. Si dhe në çdo rast tjetër të parashikuar nga ligji.

NENI 24 LIKUIDIMI

Kur verifikohet një nga shkaqet e parashikuara në Nenin 23 të këtij Statuti, Asambleja e Ortakëve cakton një ose me shumë likuidatorë të cilët do të kryejnë të gjitha veprimet e nevojshme përlikuidimin e saj, duke likuiduar në radhë të parë detyrimet e shoqërisë ndaj shtetit e me pas ndaj të tjerëve.

Në rast se kapitali i shoqërisë do të jetë i pamjaftueshëm, ortakët e shoqërisë janë detyrimin për të derdhur kuotat e tyre deri në nivelin e pjesëmarrjes në kapitalin fillestar.

NENI 25 ZGJIDHJA E MOSMARRËVESHJEVE

Mosmarrëveshjet që mund të lindin ndërmjet ortakëve ose ndërmjet ortakëve dhe shoqërisë dhe që ka lidhje me të drejta të disponoheshë në lidhje me marrëdhëniet e tyre me shoqërinë do të drejtohen për zgjidhje Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

NENI 26 LEGJISLACIONI I ZBATUESHËM

Çdo gjë që nuk është parashikuar në këtë statut do të disiplinohet nga dispozitat ligjore në fuqi në Republikën e Shqipërisë.

Tirane , me 27.10.2023

Ortaku i shoqerise “AZG STANDARD” sh.p.k

Z. Tefta Bashllari

